




**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
ENTI RREGULLATOR I  
SEKTORIT TE ENERGIJISE  
ELEKTRIKE



Bordi i Komisionerve

**V E N D I M**

**Nr.6 Datë.17.01.2008.**

**Per**

**Fillimin e procedurave per shqyrtimin e kërkesës se shoqërisë “OSSH” sha per kohezgjatjen e faturimit aforfe te energjise elektrike ne abonentet familiare pa matje**

Në mbështetje të neneve 51, 52 te Ligjit Nr. 9072 date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” i ndryshuar, dhe nenin 18, pika 1 te “Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s” te miratur me Vendimin e Bordit te Komisionereve Nr. 44, date 24.07.2007. Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të dt. 17.01.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “OSSH” sha per kohezgjatjen e faturimit aforfe te energjise elektrike ne abonentet pa matje,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave per shqyrtimin e kërkeses se shoqërisë “OSSH” sha per zgjatje afati te faturimit aforfe te energjise elektrike ne abonentet familiare pa aparat mates.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut dhe Drejtoria e Ceshjeve Ligjore dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftojne shoqërine ne lidhje me vendimin e dhene nga ERE.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare